



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 105/7 prot.

Tiranë, më 25.2.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Anita Jella
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 10.2.2020, është njoftuar vendimi nr. 221, datë 10.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim znj. Anita Jella, me funksion prokurore/Drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 12.2.2020, është depozituar akti, “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, është prokurore prej vitit 2001 dhe aktualisht ushtron detyrën e prokurores/Drejtueses në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, me përparësi në kohë, si kandidate për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, njohur ndryshe si SPAK.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin znj. Anita Jella ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK), dhe Raportin Profesional, hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Anita Jella*”, ka referuar:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar për subjektin: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

3. Pas administrimit të raporteve të mësipërme dhe hetimit administrativ të çështjes, me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, datë 18.9.2019, trupi gjykues i Komisionit i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit: (i) përfundimin e hetimit kryesisht bazuar në tria kriteret; (ii) njoftimin e rezultateve të hetimit dhe njohjen e subjektit me provat e administruara në respektim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe (iii) të drejtat ligjore që gëzon subjekti i rivlerësimit për të paraqitur parashtrime, kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

4. Për shkak të administrimit të një denoncimi nga publiku, referuar nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin e datës 4.10.2019, Komisioni ka vendosur rihapjen e hetimit administrativ, duke njoftuar dhe subjektin e rivlerësimit.

5. Në datë 6.11.2019 dhe 14.11.2019, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b<sup>1</sup>”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pikat 10<sup>2</sup> dhe 11<sup>3</sup>, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit një gjetje dhe mendim/opinion lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

6. Pas hetimit dhe administrimit të dokumentacionit në funksion të vlerësimit të denoncimeve nga publiku, gjetjes dhe opinionit të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, në datë 14.11.2019, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të mbyllë hetimin administrativ shtesë, duke njohur subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit dhe të drejtat ligjore të tij.

7. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

7.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore, krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare.

7.2 Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: *[...] subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar është pozitiv dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite, si dhe ka burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera [...]* (f. 13 e vendimit). Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se në vlerësimin e përgjithshëm subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

7.3 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka shqyrtuar deklaratën për kontrollin e figurës së subjektit, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit dhe atë të administruar gjatë hetimit lidhur me denoncimet nga publiku, ka arritur në përfundimin: *[...] se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen të përshtatshme për vazhdimin e detyrës [...]* (f. 15 e vendimit). Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

---

<sup>1</sup> Sipas nenit B, pika 3, germa “b”, përcaktohet se: [Vëzhguesi ndërkombëtar ... paraqet gjetje dhe mendime mbi çështjet që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelitimit ...].

<sup>2</sup> Sipas nenit 49, “Mjetet për kërkimin e provës”, pika 10, përcaktohet se: [Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtrohet për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelitimit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelitimit].

<sup>3</sup> Sipas nenit 49, pika 11, përcaktohet se: [Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose të Kolegjit të Apelitimit, por nuk ka vlerë në provës].

7.4 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe, për aq sa gjen zbatim, ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka vlerësuar dokumentacionin e administruar për këtë kriter, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve të publikut, gjetjes dhe opinionit të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke arsyetuar mbi kompetencat ligjore të drejtuesit të prokurorisë në raport me ato të prokurorëve, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin: [...] *se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar ligjin brenda kompetencave të saj si drejtuese dhe se mosveprimet e saj të konstatuara në dy raste nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin profesional të saj me mangësi apo të papërshtatshëm, referuar nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella: “e aftë”. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Ajo ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 37 e vendimit).*

8. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, prokurore/Drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës;*
- *Transferimin e çështjes me nr. \*\*\* akti, të regjistruar në datën \*\*\*.3.2014, pranë organit kompetent për inspektim dhe vlerësim;*
- *Transferimin e dy çështjeve që lidhen me ndjekjen e procedurës si drejtuese e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Durrës, pranë organit kompetent, për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit.*

9. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje të Komisionit, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin 55, pika 5<sup>4</sup>, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur një mendim ndryshe, bashkuar vendimit të Komisionit.

## II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

10. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c<sup>5</sup>”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2<sup>6</sup>, të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 12.2.2020, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: *“Rekomandim për paraqitje ankimi”* ndaj vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Anita Jella (bashkëlidhur këtij ankimi).

11. Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, për rivlerësimin e: (i) kriterit të pasurisë; (ii) kriterit të aftësive profesionale dhe (iii) vlerësimit në tërësi të çështjes. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i

<sup>4</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit.

<sup>5</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

<sup>6</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

rivlerësimit për znj. Jella të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe, në përfundim, vendimi i Komisionit të ndryshohet, pasi nga vlerësimi i këtij rasti vërehen disa mangësi:

11.1 Për kriterin e pasurisë:

- *Subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e banesës së porositur nga vëllai i bashkëshortit, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2011 - 2016.*
- *Ka mospërputhje lidhur me vlerën e deklaruar në deklaratën “Vetting”, në shumën 2.500.000 lekë, për shlyerjen e këstit të parë të pasurisë.*

11.2 Për kriterin e aftësive profesionale:

- *Si pasojë e mungesës së një politike të unifikuar, në funksion të mënyrës së ushtrimit të kompetencave si drejtuese e Prokurorisë së Durrësit, referuar nenit 43, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti, jo vetëm që ka shkaktuar pabarazi në trajtimin e çështjeve nga kjo prokurori, por, në të paktën dy raste, ka shkaktuar një seri ngjarjesh procedurale që kanë synuar mbrojtjen e autorëve të pretenduar të veprës penale, një prej tyre zyrtar publik dhe tjetri magjistrat (procedimi penal nr. \*\*\*/2019 dhe ai me nr. \*\*\*/2019).*
- *Mungesa e një sistemi regjistrimi efektiv dhe efikas në zyrën e Prokurorisë Durrës, për muajin gusht të vitit 2019, lidhur edhe me faktin se si procedimi penal ndaj shtetasit \*\*\*,\*\*\* dhe të tjerë u menaxhuan në atë periudhë.*

11.3 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sigurojë prova që të justifikojnë mangësitë e konstatuara. Në këto kushte, kjo duhet të ishte konsideruar brenda kornizës së vlerësimit të përgjithshëm, sipas nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

11.4 Si përfundim, ONM-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, i rekomandon Komisionerit Publik të ushtrojë ankim mbi të gjithë vendimin nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të znj. Anita Jella.

11.5 Ankimi ndaj këtij vendimi duhet të shtrihet në trajtimin e tria kriterëve të rivlerësimit, në mënyrë që t’i japë mundësi juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të veprojë, bazuar jo vetëm në pikën 3 dhe 4, të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, por edhe sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, të vlerësojë të gjitha pikat e dispozitivit të vendimit nr. 221/2019, përfshirë tri procedimet penale të referuara sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**12.** Në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**13.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

**14.** Në krahasim me kompetencat që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit (Komisionit).

**15.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**16.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 221/2019, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**17.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe jo vetëm, për të cilat Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën, lidhur me: **(i)** deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë; **(ii)** procedimin penal nr. \*\*\*/2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; **(iii)** procedimin penal nr. \*\*\*/2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; **(iv)** procedimin penal nr. \*\*\*/2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; **(v)** mungesën e koordinimit dhe ekzistencën e një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në muajin gusht të vitit 2019.

**18.** Në referencë të përmbajtjes të pikës 2, të nenit 4, të pikës 1, të nenit 59 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i çështjeve të lartpërmendura nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

**19.** Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

### **III. A. Pranueshmëria e ankimit**

**20.** Komisioneri Publik e sheh të nevojshme që, përpara se të vijojmë me analizën e shkaqeve të ankimit, dhe për të cilat Kolegji do të shprehet në saje të juridiksionit të tij kontrollues dhe rivlerësues, në konsideratë të arsytimit të rekomandimit të ONM-së dhe mënyrës së disponimit të Komisionit, fillimisht të sqarojmë kushtet e pranueshmërisë së këtij ankimi, i cili ushtrohet kundër vendimit të Komisionit në tërësinë e tij, përfshirë dhe tri çështjet penale të referuara nga ky i fundit (Komisioni), organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

**21.** Konstatohet se Komisioni në dispozitivin e vendimit nr. 221/2019, në pikën 5, ka specifikuar se: [... *pika 1 e këtij vendimi* (disponimi mbi konfirmimin në detyrë të subjektit) mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të Komisionit...], përcaktim i cili nënkupton se pikat e tjera të dispozitivit të këtij vendimi përjashtohen nga e drejta e palëve për ankim, përfshirë këtu dhe Komisionerin Publik.

**22.** Komisioneri Publik vlerëson të rikujtojë qëndrimin e mbajtur në raste të ngjashme ankimi<sup>7</sup>, në të cilat argumenton se ndalimi i parashikuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen zbatim dhe nuk ndikon në të drejtën e Komisionerit Publik për të ushtruar ankim, kur në cilësinë e një prej tri institucioneve të rivlerësimit, si përfaqësues i interesit publik, për qëllim të nenit 179/b, të Kushtetutës, konstaton se vendimmarrja e Komisionit nuk është marrë në përputhje me ligjin dhe nuk mbështetet në prova apo subjekti nuk plotëson kushtet që të përliqë konfirmimin e tij në detyrë.

**23.** Komisioneri Publik, bazuar në një interpretim literal e logjik të përmbajtjes së nenit 59 “*Konfirmimi në detyrë*”, në harmoni me dispozitat e tjera të ligjit dhe të aneksit të Kushtetutës, vlerëson se kjo normë rregullon një situatë ligjore që i referohet përmbjlljes me sukses të procesit të rivlerësimit, të ndjekur nga Komisioni kundrejt subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst çmohet se ndalimi i shprehur në pikën 4, të këtij neni, i shtrin efektet vetëm ndaj subjektit të rivlerësimit të konfirmuar në detyrë, si masë proporcionale dhe në balancë me të drejtat dhe detyrimet e tij, për sa kohë që, me transferimin e çështjes për shqyrtim organit përgjegjës inspektues, e më pas organeve vendimmarrëse të juridiksionit disiplinor<sup>8</sup>, subjektit i garantohen të gjitha të drejtat në funksion të një procesi të rregullt ligjor.

**24.** Në këtë vështrim, nëse do të interpretonim në të kundërt me sa më lart, se kufizimi i nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, i shtrin efektet edhe ndaj Komisionerit Publik, eventualisht, kjo do të binte ndesh me kompetencat e parashikuara nga pika 2, e nenit C dhe pika 2, e nenit F, të aneksit të Kushtetutës, dhe njëkohësisht do të pamundësonte juridiksionin rivlerësues dhe kontrollues të vetë Kolegjit ndaj çështjeve të transferuara nga Komisioni, por për të cilat Komisioneri Publik, bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se kanë ndikim thelbësor në vlerësimin drejt të subjektit të rivlerësimit.

**25.** Referuar analizës së tri çështjeve të transferuara, në një vlerësim tërësor të çështjes, konstatohet se ato përbëjnë mjaftueshëm një bazë të dhënash që, për qëllim të procesit të rivlerësimit, e bëjnë vendimmarrjen e Komisionit të cenusshëm.

#### **IV. Analiza e shkaqeve të ankimit**

##### **IV.A. Për vlerësimin e pasurisë**

**26.** Në lidhje me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“*Vetting*” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe

<sup>7</sup> Për më tepër referohuni në ankimet e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 84/2018, nr. 161/2019 dhe nr. 200/2019, të Komisionit.

<sup>8</sup> Për më tepër në këtë drejtim, referohuni dhe në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës.

të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

27. Nga aktet e administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Jella, në Deklaratën “Vetting”, dorëzuar më datë 25.1.2017, ka deklaruar, ndër të tjera pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*.\*\*\*\*”, nr. \*\*\*\*, kati i katërt, Durrës.

28. Rezulton se kjo pasuri e paluajtshme, fillimisht është deklaruar nga personi i lidhur \*\*\*\*.\*\*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DV-2011, si vijon: Kontratë sipërmarrje me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë \*\*\*\*.8.2011, me porositës \*\*\*\*.\*\*\*\*, dhe palë investitore, shoqëria “\*\*\*\*” SHPK. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, porositësi ka rënë dakord me sipërmarrësin për ndërtimin e një apartamenti, të identifikuar me nr. \*\*\*\*, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 97 m<sup>2</sup>, për çmimin 67.900 euro. Palët kanë rënë dakord që kjo shumë të likuidohet me këste si vijon: (i) kësti i parë në shumën 15.000 euro, likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale; (ii) kësti i dytë në shumën 40.000 euro, do të likuidohet brenda datës \*\*\*\*.10.2011 dhe (iii) kësti i tretë dhe i fundit, prej 12.900 euro, do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.

28.1 Në DV-2016, dorëzuar më datë 24.3.2017 (pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”), subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se apartamenti i deklaruar në DV-2011 nga bashkëshorti është këmbyer me apartamentin e porositur nga vëllai i bashkëshortit, apartament i cili ndodhet në të njëjtin objekt me apartamentin e porositur në vitin 2011. Përveç këmbimit, kushtet e tjera nuk kanë pësuar ndryshime dhe se referimet do t’i bëhen kontratës së porosisë së deklaruar në vitin 2011. Apartamenti i porositur fillimisht nga subjekti në vitin 2011, i është kthyer shoqërisë ndërtuese dhe, referuar deklarimeve të subjektit, kjo shoqëri i ka kthyer kunatit të subjektit çmimin e paguar për apartamentin të cilin subjekti ka aktualisht në përdorim.

28.2 Gjatë hetimit administrativ, referuar pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nëse në shtatë vitet e fundit ka përdorur pasuri të regjistruar në emrin e dikujt tjetër, ka sqaruar se: [...] *Nga dhjetori i vitit 2011 kemi përdorur apartamentin e ndodhur në lagjen nr. \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*.\*\*\*\*”, pallati \*\*\*\*, kati i katërt, hyrja nr. \*\*\*\* (apartament në të cilin banoj aktualisht), i cili deri përpara përpilimit të deklaratës noteriale nr. \*\*\*\* rep./\*\*\*\* kol. ka qenë porositur nga vëllai i bashkëshortit tim, \*\*\*\*.\*\*\*\*. Arsyeja e përdorimit të këtij apartamenti ka qenë se në momentin kur kemi ardhur për të banuar në këtë apartament, pallati ishte në ndërtim e sipër, ndërsa kjo hyrje ishte pothuajse e përfunduar. Pasi jemi akomoduar në këtë banesë, \*\*\*\*.\*\*\*\* ka hequr dorë nga blerja e apartamentit dhe kemi rënë dakord me ndërtuesin që ne ta përfitojmë këtë apartament, pasi jetonim aktualisht, duke hequr dorë nga apartamenti i porositur nga ana jonë [...].*

28.3 Nga përmbajtja e akteve të administruara, konstatojmë se apartamenti, i prenotuar në vitin 2011 nga bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit, ndodhet në katin e dytë të ndërtimit, me sip. prej 97 m<sup>2</sup>, porositur kundrejt çmimit 67.900 euro, ndërsa apartamenti i porositur nga kunati i subjektit ndodhet në katin e katërt të banimit, me sip.113 m<sup>2</sup>, porositur kundrejt një çmimi prej 71.190 euro. Ky apartament nuk është regjistruar në ZVRPP-në Durrës dhe, referuar përmbajtjes së kontratave dhe shpjegimeve të subjektit, kjo është dhe arsyeja pse kësti i fundit, prej 12.900 euro, nuk i është paguar akoma shoqërisë ndërtuese.

28.4 Rezulton se, përveç pagesës së këstit të dytë, pas disbursimit të kredisë nga \*\*\*\* dhe kalimit të kësaj shume në favor të shoqërisë ndërtuese, subjekti nuk ka dokumentuar asnjë transaksion tjetër të kryer me këtë shoqëri apo kthimet e pagesave nga kjo e fundit te shtetasi



\*\*\*.\*\*\* (kunati), pas heqjes dorë prej tij nga blerja e apartamentit<sup>9</sup>, i cili, sikurse deklaroi subjekti, është këmbyer me atë të porositur fillimisht prej bashkëshortit të saj.

28.5 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi arsyet e mosdeklarimit të përdorimit të këtij apartamenti dhe shkëmbimit të tij me apartamentin e porositur në vitin 2011 dhe, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ të datës 19.9.2019, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *Nga ana jonë në DPV është dhënë adresa e banimit, e cila është e njëjtë për të dy apartamentet, pasi ndodhen në të njëjtin pallat. Gjithashtu sqarojmë se në asnjë seksion të DPV-së nuk ka qenë e detyrueshme dhe nuk kërkohej deklarimi i sendeve të paluajtshme në përdorim. Ky ndryshim është bërë me ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017, ku është parashikuar detyrimi i subjekteve për deklarimin e sendeve dhe të drejtave reale mbi to sipas Kodit Civil [...].*

**29. Komisioneri Publik** vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e përdorimit të kësaj pasurie, nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë në kundërshtim me faktet e dala nga hetimi administrativ. Sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, parashikohet qartë objekti i deklarimit, ku konkretisht në pikën 1, germa “a”, përcaktohet se duhen deklaruar *“pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”*. Ndryshimi ligjor i mëpasshëm i vitit 2017, në të cilin bazohet subjekti, ka bërë vetëm një saktësim, ku është shtuar togfjalëshi *“sipas Kodit civil”*, pa ndryshuar asgjë në thelbin e detyrimit për deklarim. Referuar dhe jurisprudencës të Gjykatës së Lartë<sup>10</sup>, posedimi bën pjesë në të drejtat reale e për të cilat, në kontekstin e detyrimit ligjor të deklarimit të pasurisë, përbënte detyrim për t’u zbatuar nga ana e subjektit të rivlerësimit për vitet 2011 - 2016, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016, dhe plotësimit të Deklaratës “Vetting”.

29.1 Vendosim në vëmendje se subjekti ka rënë dakord me palët e interesuara që, në gusht të vitit 2011, ky do të ishte apartamenti i cili do të blinte, pasi ka bërë shpenzime për ta përshtatur për jetesë, si dhe kontrata e energjisë elektrike për këtë apartament figuron të jetë lidhur në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**30.** Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në D-Vett., ka deklaruar: (i) *kredi në \*\*\* me vlerë 5.650.000 lekë, marrë nga bashkëshorti në vitin 2011*, si dhe (ii) *me kursimet e deklaruar në vite kam kontribuar në pagesën e kësteve për apartamentin e deklaruar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2011, dhe deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2016, gjithsej 2.500.000 lekë.*

30.1 Në DV- 2011, personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti, ka deklaruar si burim të blerjes së kësaj pasurie: (i) kredinë e marrë nga \*\*\*-ja dhe (ii) kursime nga pagat.

30.2 Lidhur me burimin e deklaruar, *kursime nga pagat në vite*, bazuar në nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, nga verifikimi i deklaratave periodike mbi deklarimin e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2011, rezulton se në DV-2004 - 2006, subjekti deklaroi kursime në *cash*, duke iu referuar si: *“gjendje cash në fund të vitit”*, ndërsa në deklaratat DV-2007 - 2010, deklaroi kursime në *cash*, duke iu referuar si: *“kursime nga paga në cash në shtëpi”*.

<sup>9</sup> Porositur me kontratën me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2010.

<sup>10</sup> Referohuni dhe vendimit njëses të Gjykatës së Lartë, nr. 11118-02138-00-2018 regj. themeltar, nr. 00-2014-26181 i vendimit nr. 385, datë 17.6.2014.

30.3 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit saktësimin e kursimeve në *cash* për çdo vit, në përgjigje të të cilit<sup>11</sup>, subjekti ka deklaruar se: “*gjendja e likuiditeteve në fund të çdo viti (deklaruar vetëm shtesat për çdo vit deklarimi) ka qenë si në vijim: (1) Viti 2003: nuk kam likuiditete cash; (2) Viti 2004: likuiditete në shumën 300.000 lekë; (3) Viti 2005: likuiditete në shumën 800.000 lekë; (4) Viti 2006: likuiditete në shumën 1.500.000 lekë; (5) Viti 2007: likuiditete në shumën 2.002.000 lekë; (6) Viti 2008: likuiditete në shumën 2.470.000 lekë; (7) Viti 2009: likuiditete në shumën 2.630.000 lekë; (8) Viti 2010: likuiditete në shumën 2.200.000 lekë; (9) Viti 2011: nuk kam më likuiditete cash në fund të vitit*”.

30.4 Për sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar: (i) *Mospërputhje midis vlerës së deklaruar në Vetting, nga subjekti për pagesën e këstit të parë, prej 2.500.000 lekësh, dhe vlerës së deklaruar prej 2.200.000 lekësh nga subjekti në DV-2010, si gjendje e kursimeve cash në fund të vitit, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit.* (ii) *Nga analiza financiare duket se subjekti e justifikon me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë prej 15.000 euro, por nuk provohet me dokumentacion kryerja e pagesës së këstit të parë në vlerën 15.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (transfertë bankare, mandatarkëtimi nga shoqëria).* Në këto kushte, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë bindshëm se të gjitha veprimet e kryera lidhur me përfitimin e këtij apartamenti janë deklaruar saktësisht, janë në përputhje me ligjin dhe mbulohen me burime financiare të ligjshme.

30.5 Subjekti i rivlerësimit, për mospërputhjen midis vlerës së deklaruar (në përgjigje të pyetësorëve) të kursimeve të disponuara në fund të vitit 2010, prej 2.200.000 lekësh, dhe vlerës së deklaruar në Deklaratën “Vetting”, prej 2.500.000 lekësh, ka shpjeguar se: “*... në DV-2011 është pasqyruar fakti i pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit 15.000 euro ose rreth 2.050.000 lekë. Ndërkohë, gjatë këtij viti, janë bërë shpenzime për rregullime të brendshme të apartamentit në vlerën 450.000 lekë, nga të cilat janë përdorur pjesa e mbetur nga shuma e kursimeve prej 2.200.000 lekësh (150.000 lekë) dhe pjesa tjetër, prej 300.000 lekësh nga kursimet e vitit 2011*<sup>12</sup>”.

30.6 Lidhur me vlerën e likuiditeteve të poseduara në *cash*, në vitin 2010, subjekti ka saktësuar se<sup>13</sup>: *në vitin 2010 ka përdorur një pjesë të kursimeve cash ndër vite që i ka pasur gjendje në këtë periudhë. Si rezultat i të ardhurave të marra gjatë vitit 2010, kemi zëvendësuar deri në fund të vitit një pjesë të kursimeve të shpenzuara dhe, në përfundim, ka mbetur pa u mbuluar vlera prej 430.000 lekësh.*

30.7 Lidhur me dokumentimin e pagesës së këstit të parë të apartamentit, subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka sqaruar se *është bërë në cash jashtë zyrës së noterisë, disa momente para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, ky fakt është formalizuar në kontratën noteriale, e cila është nënshkruar nga të dyja palët dhe nga noterja. Në kohën kur është lidhur kontrata nuk ka qenë e detyrueshme që pagesat të kryheshin nëpërmjet llogarisë së noterit.*

30.8 Në përfundim, Komisioni ka argumentuar se nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në

<sup>11</sup> Referohuni përgjigjeve të email-it të datës 17.6.2019.

<sup>12</sup> Referohuni përgjigjeve të subjektit lidhur me rezultatet e hetimit administrativ.

<sup>13</sup> Referohuni përgjigjeve të email-it të datës 28.6.2019.

përputhje me ligjin. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar është pozitiv dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite, si dhe ka burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera. Në vlerësimin e përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

**31. Komisioneri Publik** çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është në pajtueshmëri me provat e administruara në dosje, pasi:

31.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se subjekti ka deklaruar kursime në *cash* respektivisht:

- DV- 2003: subjekti nuk deklaroi kursime në *cash*;
- DV- 2004: subjekti deklaroi gjendje në *cash* 300.000 lekë;
- DV- 2005: subjekti deklaroi gjendje në *cash* 500.000 lekë;
- DV- 2006: subjekti deklaroi gjendje në *cash* nga kursimet, nga paga, 700.000 lekë;
- DV- 2007: subjekti deklaroi kursime nga paga në *cash*, mbajtur në shtëpi, 520.000 lekë;
- DV- 2008: subjekti deklaroi kursime nga paga në *cash*, në shtëpi, 450.000 lekë;
- DV- 2009: subjekti deklaroi kursime nga paga *cash*, në shtëpi, 160.000 lekë;
- DV- 2010: subjekti nuk deklaroi ndryshime në kursime, në *cash*.

31.2 Në përgjigjet e saj, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se<sup>14</sup>: “*gjendja e likuiditeteve në fund të çdo viti (deklaruar vetëm shtesat për çdo vit deklarimi) ka qenë*”:

- Viti 2003: nuk kam likuiditete *cash*;
- Viti 2004: likuiditete në shumën 300.000 lekë;
- Viti 2005: likuiditete në shumën 800.000 lekë;
- Viti 2006: likuiditete në shumën 1.500.000 lekë;
- Viti 2007: likuiditete në shumën 2.002.000 lekë;
- Viti 2008: likuiditete në shumën 2.470.000 lekë;
- Viti 2009: likuiditete në shumën 2.630.000 lekë;
- Viti 2010: likuiditete në shumën 2.200.000 lekë;
- Viti 2011: nuk kam më likuiditete *cash* në fund të vitit.

31.3 Po ashtu rezulton se subjekti, në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, ka deklaruar se ka përdorur (pakësuar) kursimet e poseduara në *cash*, në vlerën 430.000 lekë, në vitin 2010, por kjo shumë nuk rezultoi e deklaruar në deklaratën periodike të vitit respektiv.

31.4 Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, kursimet në deklaratat periodike vjetore. Referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, në përputhje edhe me nenin 32/5, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>15</sup>, shuma aritmetike e kursimeve në *cash* deri në fund të vitit 2010, rezultoi në vlerën rreth 1.830.000 lekë, shumë e cila nuk përputhet as me shumën e saktësuar nga vetë subjekti në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit administrativ, prej 2.200.000 lekësh, dhe as me shumën e deklaruar nga subjekti në Deklaratën

<sup>14</sup> Referohuni përgjigjeve të email-it të datës 17.6.2019.

<sup>15</sup> Për më tepër referohuni në vendimet (JR) nr. 9/2018, nr. 5/2019, nr. 7/2019, nr. 11/2019 dhe nr. 19/2019.

“Vetting”, prej 2.500.000 lekësh, për pagesën e kështit të parë të apartamentit, më të ardhurat e kursyera ndër vite.

31.5 Gjithashtu, edhe shpjegimet e subjektit mbi investimet e kryera në apartament, në vlerën 450.000 lekë, që kanë mbuluar diferencën e çmimit prej 3.290 euro midis dy kontratave të sipërmarrjes<sup>16</sup>, nuk provohen me dokumentacion dhe nuk përputhen me diferencën midis kursimeve të deklaruara të poseduara deri në fund të vitit 2010, dhe ato të deklaruara në Deklaratën “Vetting”.

31.6 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklaram për kontrollin e pasurisë, nuk ka bërë deklaram të saktë, sipas nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016. Ka mospërputhje midis vlerave të kursimeve të deklaruara për pagesën e kështit të parë të apartamentit, referuar deklaratave periodike vjetore, Deklaratës “Vetting” dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Si rrjedhojë e deklarimeve të pamjaftueshme, të pasakta dhe kontradiktore të subjektit, nuk mundësohet kontrolli i pasurisë dhe i arritjes së një përfundimi, nëse kësti i parë i paguar mbulohet nga të ardhura me burime të ligjshme, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

#### ***IV.B. Për vlerësimin e aftësive profesionale***

**32.** Prej vitit 2008, subjekti i rivlerësimit, znj. Jella, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe, nga 9 maji i vitit 2018, është emëruar si drejtuese pranë kësaj prokurorie. Bazuar në përcaktimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësinë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>17</sup>, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

**33.** Referuar burimeve dhe procedurës së përcaktuar nga ky kuadër ligjor, duke përfshirë në këtë vlerësim edhe denoncimin e fakteve nga publiku, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, të tilla që, për nga niveli i provueshmërisë së tyre, bazuar në nenin 52, të këtij ligji, subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën. Në këtë vlerësim, Komisioni ka administruar një *gjetje* në datën 6.11.2019 dhe një *opinion* në datën 14.11.2019, nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes (bashkëlidhur këtij ankimi), të cilat në kuptim të nenit 49, pikat 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen si provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur, apo një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezultojnë nga faktet në çështje të veçanta.

<sup>16</sup> Kontratës së nënshkruar nga \*\*\*.\*\*\*, për blerjen e apartamentit në vlerën 71.190 euro dhe kontratës së nënshkruar nga \*\*\*.\*\*\*, për blerjen e apartamentit në vlerën 67.900 euro, sikundër analizuar në pikën 28.

<sup>17</sup> Për më tepër, referohuni në nenet 73-77, 84, 90, 91 etj., të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar. Lidhur me afatin brenda të cilit shtrihet vlerësimi, ai është 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, por ky afat mund të shtrihet edhe nga 1 janari 2006, e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, referuar nenit 41, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në numër çështjesh/dosjesh/vendimesh të ndryshme, në të cilën përcaktohen 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, referuar nenit 43, pika 2 dhe shtojcës 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

34. Për sa më sipër, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ dhe atyre shtesë të Komisionit, dhe akteve të administruara për këtë qëllim, çështjet për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe që i janë kërkuar shpjegime, janë si më poshtë.

35. *Procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2014, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në të cilën subjekti ka pasur rolin e prokurores, që ka hetuar çështjen (çështje e përzgjedhur me short nga pesë dosjet e vlerësuara).*

35.1 Nga përmbajtja e akteve të këtij procedimi penal, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se çështja është regjistruar mbi bazën e materialeve hetimore të sjella nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Durrës, ku dyshohej për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit \*\*\*.\*\*\*.

35.2 Për këtë ngjarje, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, janë kryer veprimet hetimore, në kuadër të këqyrjes dhe marrjes së provave materiale të dyshuara si lëndë narkotike, sekuestrimin dhe peshimin e saj, kryerjes së ekspertimit kimik, atij toksikologjik, si dhe është pyetur shtetasi \*\*\*.\*\*\*<sup>18</sup>, vëllai i \*\*\*.\*\*\*, i cili ka qenë dhe personi që ka njoftuar policinë<sup>19</sup>. Për shtetasin \*\*\*.\*\*\* është proceduar me arrestimin në flagrancë për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1, i Kodit Penal, dhe në vazhdim materialet janë përcjellë në prokurori, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

35.3 Nga ana e subjektit, më datë 11.3.2014, është depozituar kërkesa për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2014, pasi i ka gjetur të bazuara kërkesat e prokurorisë, ka vendosur vlerësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të dyshuarit \*\*\*.\*\*\* dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal, atë të “arrestit me burg”, parashikuar nga neni 238, i Kodit Penal.

35.4 Nga akti i ekspertimit toksikologjik ka rezultuar se në mostrën e urinës së personit nën hetim, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, është zbuluar prania e morfinës, monoacetilmorfinës dhe acetilkodeinës. Ndërsa nga akti i ekspertimit kimik të lëndëve të sekuestruara është gjendur prania e paracetamolit dhe kafeinës.

35.5 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, më datë 29.4.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2014, bazuar në nenin 328, paragrafi 1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale.

35.6 Referuar arsyetimit të Komisionit lidhur me këtë çështje, ky i fundit, fillimisht, ka arritur në përfundimin se: *“për shkak të sjelljes së subjektit të rivlerësimit, disa mundësi hetimore u humbën plotësisht<sup>20</sup>”* dhe, pasi ka kërkuar shpjegime nga subjekti, nuk rezulton të ketë vlerësuar nëse këto shpjegime gjenden të drejta apo janë bindëse, dhe raportin që zënë konstatimet e tij (Komisionit), për rastin, në kontekstin e procesit të rivlerësimit. Nga përmbajtja e vendimit, kjo çështje është përfshirë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të aftësive profesionale dhe i është transferuar së bashku me dy çështje të tjera, organit kompetent për inspektim, referuar nenit 59/4, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>18</sup> Shtetasi \*\*\*.\*\*\* ka shpjeguar se ai banon në këtë banesë me nënën dhe vëllain. Ky i fundit është përdorues i lëndës narkotike, edhe për këtë ka pasur problem me drejtësinë.

<sup>19</sup> Referimi i kësaj vepre penale lidhet me një ngjarje të datës 9.3.2014, ku pasi është sinjalizuar për një konflikt në familjen e shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe pasi patrulla e policisë ka shkuar në banesën e këtij të fundit, kanë vënë re një qese me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë, e cila për nga karakteristikat ngjasonte me atë të llojit heroinë, si dhe tre porcione të mbështjella në formë pakoje, brenda të cilave kishte përmbajtje pluhuri.

<sup>20</sup> Për më tepër referohuni në f. 15-16, të vendimit të Komisionit.

**39. Komisioneri Publik**, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, përfshirë këtu dhe dy praktikat e tjera penale të transferuara (trajtuar në vijim), çmon se vlerësimi i Komisionit është marrë në interpretim të gabuar të nenit 59, pikat 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me nenin 4, pika 2, dhe 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2018, duke nxjerrë jashtë juridiksionit rivlerësues këto çështje.

39.1 Komisioneri Publik vlerëson se, në referencë të rolit që Kushtetuta i njuh Komisionit, neni 179/b, pika 5, dhe qëllimit të shprehur në pikën 1, të kësaj dispozite, në cilësinë e organit rivlerësues, Komisioni, përpara se të vendosë transferimin e një çështje apo për më tepër, të disave në të cilat janë konstatuar mangësi, fillimisht duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi, lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59/4 i ligjit kërkon, si: *“evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore”* apo *“shkaqeve për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit”*, duke arsyetuar dhe nëse për këto raste gjen apo jo zbatim neni 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë këndvështrim, shmanget dhe rreziku i transferimeve *apriori* të çështjeve tek organi kompetent për inspektim apo mundësia që këto praktika të mund të mos pranohen dhe shqyrtohen nga ky organ, referuar nenit 117, pika 1<sup>21</sup>, 120, pika 1, germa “b<sup>22</sup>”, dhe nenit 124, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, e rrjedhimisht ato arkivohen.

39.2 Duke iu rikthyer procedimit penal nr. \*\*\*/2014, në të cilin dhe vetë Komisioni ka konstatuar të njëjtat mangësi, për Komisionerin Publik provohet që hetimi penal i ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i plotë dhe paraqet mangësi, pasi:

- (i) Nuk rezulton të jetë krahasuar përmbajtja e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizave të ekspertimit të ndërmarrë në kuadër të këtij hetimi, nga të cilat rezultonin mospërputhje me deklaratimet e të dyshuarit.
- (ii) Subjekti duhet t’i kishte kushtuar vëmendje këtyre rrethanave, sidomos në kushtet kur personi i dyshuar ishte person me precedent të mëparshëm penal.

**40. Procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit).**

40.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal nga një denoncim nga publiku, në të cilin pretendohet se subjekti në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë Durrës ka ndikuar në pushimin e çështjes dhe asgjësimit të provave, lidhur me një kallëzim penal kundër shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe gjyqtarës \*\*\*.\*\*\*.

40.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2019, ka vendosur në dispozicion kopje të fashikullit penal nr. \*\*\*, të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale: “Ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal, regjistruar për shtetasin \*\*\*.\*\*\*.

40.3 Për këtë procedim penal, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se në datën \*\*\*.5.2019, shtetasja \*\*\*.\*\*\* ka dorëzuar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kallëzimin penal ndaj shtetases \*\*\*.\*\*\*, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit

<sup>21</sup> Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk e verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk e fillon hetimin për shkak të parashkrimit.

<sup>22</sup> Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme: ... “b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor”.

Tiranë, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi kallëzuesja pretendon se në dosjen gjyqësore të të kallëzuarës është gjendur një vendim i parapërgatitur, i cili favorizonte palën tjetër kundërshtare në një proces civil, shtetasin \*\*\*.\*\*\*. Ndaj këtij të fundit, kallëzuesja ka paraqitur gjithashtu kallëzim, për veprën penale: “Ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal, duke pretenduar se ky shtetas është parë në ambientet e hotel “\*\*\*\*”, me bashkëshortin e gjyqtarës \*\*\*.\*\*\*, në ditët kur kanë qenë duke u zhvilluar seancat gjyqësore.

40.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ia ka përcjellë materialet për kompetencë lëndore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila gjithashtu ia përcjell për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit, pasi pranon aktet, regjistron procedimin penal, me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2019, vetëm në ngarkim të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, për veprën penale: “Ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Ndërsa për personin tjetër të kallëzuar, gjyqtaren \*\*\*.\*\*\*, kjo Prokurori nuk regjistron procedim penal, pa vlerësuar nëse hetimi duhet të fillojë apo janë kushtet ligjore për të marrë vendim mosfillimi.

40.5 Gati tre muaj më pas, në datën \*\*\*.9.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dërgon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2019, regjistruar ndaj shtetasit \*\*\*.\*\*\*, por gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2019, vendos mospranimin e kërkesës së prokurorit.

40.6 Në marrjen e këtij vendimi, Gjykata ka vlerësuar se hetimet nuk janë të plota dhe dosja duhet të kthehet për plotësimin e hetimeve, duke caktuar edhe veprimet hetimore shtesë, ku, ndër të tjera, përcaktohet se përderisa ka një kallëzim penal edhe ndaj shtetasës \*\*\*.\*\*\*, prokurori duhet të kishte dalë me vendim apo kërkesë edhe për këtë rast, për këtë shkak urdhërohet prokurori që të përpilojë një akt procedural edhe për këtë rast<sup>23</sup>. Rezulton se prokurori i çështjes, \*\*\*.\*\*\*, nuk ka qenë dakord me këtë urdhërim të gjykatës dhe, më datë \*\*\*.10.2019, ka ankimuar vendimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

40.7 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 11, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur opinionin e datës 14.11.2019, duke i kërkuar Komisionit që, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit t’i kalohet barra e provës për të dhënë shpjegime dhe prova bindëse, në justifikimin e mungesës së kontrollit mbi mosregjistrimin e emrit të shtetasës \*\*\*.\*\*\*, mosfillimin e hetimit ndaj saj apo dhe mundësinë për vlerësimin nëse duhej të fillonte hetimi.

40.8 Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit dhe, për të provuar të kundërtën, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *[...]Nënvizoj faktin se ndryshimet e fundit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë”, ndryshuan në thelb funksionimin e prokurorisë nga një organ i centralizuar<sup>24</sup> në një organ të pavarur, që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim. Hetimi dhe ndjekja penale është kompetencë vetëm e prokurorëve të çështjeve... Drejtuesi i*

<sup>23</sup> Për më tepër referohuni rezultateve të hetimit administrativ shtesë.

<sup>24</sup> Neni 148/2, i Kushtetutës, para ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016.

prokurorisë, në zbatim të ligjit organik, mund të japë udhëzime jo të detyrueshme për një çështje konkrete<sup>25</sup>, të cilat nuk duhet të cenojnë pavarësinë e prokurorit për zgjidhjen e çështjes. ... Lidhur me shqetësimin e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar ... subjekti sqaron se materiali kallëzues fillimisht është trajtuar nga Prokuroria për Krime të Rënda, e cila është kompetente për hetimin e veprave të korrupsionit të gjyqtarëve ose prokurorëve. Pra, kalimi i këtij materiali për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas në atë të Durrësit, nuk përfshin hetimin e dyshimeve për korrupsion ndaj gjyqtarës [...]. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nga zëvendës drejtuesi i Prokurorisë, në këtë rast janë caktuar si dispozita për t'u hedhur në short nenet 248 dhe 245/1, të Kodit Penal, duke paraqitur dhe shënimin përkatës si provë.

40.9 Edhe për këtë rast, referuar konkluzioneve (f. 36-37 të vendimit), Komisioni, pasi arsyeton mbi ndryshimet e reja kushtetuese dhe legjislacionit procedural penal, lidhur me pavarësinë e funksionit të prokurorit dhe vendimmarrjes së tij, ka vlerësuar se mosveprimet e konstatuara të subjektit (në dy raste) nuk mund të përbëjë shkak për vlerësimin e tij me mangësi apo të papërshtatshme, duke vendosur transferimin e kësaj çështjeje pranë organit kompetent inspektues, për t'u marrë parasysh në vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit.

**41. Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk duhej të transferohej pranë organit kompetent për inspektim (sikurse kemi parashtruar në pikën 39).

41.1 Komisioneri Publik vlerëson se ndryshimet e reja ligjore, përfshirë ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionin e prokurorisë në RSH", nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të drejtuesit të Prokurorisë, rol të cilit ky ligj ia njeh me anë të kompetencave udhëzuese dhe me natyrë jo detyruese. Subjekti i rivlerësimit, posaçërisht për shkak të detyrës funksionale që ushtron si drejtuese e Prokurorisë, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjes dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, bazuar në nenin 43<sup>26</sup>, të ligjit nr. 97/2016, përpara se nga prokurori i çështjes të merrej vendim mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.

41.2 Në rastin konkret nuk evidentohet ndonjë komunikim i drejtuesit të Prokurorisë, subjektit të rivlerësimit me prokurorin e çështjes apo subjekti të ketë udhëzuar mbi ecurinë e rastit, pavarësisht faktit se ato janë të karakterit jo detyrues për zbatim. Në kontekstin e rrethanave të çështjes, kjo do të ishte e nevojshme, pasi, sikurse pranon dhe subjekti, *në këtë rast janë caktuar si dispozita për t'u hedhur në short materiali, nenet 248 dhe 245/1, të Kodit Penal*. Për më tepër kur, në mungesë apo harresë të veprimeve procedurale për këtë vepër penale, shpërdorim të detyrës, të pretenduar për një anëtare të gjyqësorit, Gjykata e Shkallës

<sup>25</sup> Neni 48/2, i ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikon se: "2. Udhëzimet për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme".

<sup>26</sup> Drejtuesi i Prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: a) koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete; b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; c) jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj; dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.



së Parë Durrës ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes, duke vlerësuar nevojën dhe urdhëruar kryerjen e veprimeve të tjera procedurale.

41.3 Shpjegimi i subjektit se, bazuar në ndryshimet e reja ligjore, në këtë rast shfaqet thjesht si nënshkruese e shkresës përcjellëse dhe ecuria e procedimit penal është përgjegjësi vetëm e prokurorit të çështjes, nuk e justifikon mosveprimin si drejtuese e Prokurorisë, referuar neneve 43 dhe 48, të ligjit nr. 97/2016. Parë kjo në raport me raste të tjera të ngjashme (trajtuar në vijim) ku subjekti, duke shfrytëzuar pikërisht pozitën e drejtueses dhe hapësirat e reja ligjore, si dhe duke ndërmarrë veprime aktive, vendos standard të ndryshëm në ecurinë e çështjes penale.

41.4 Po kështu dhe shpjegimi i subjektit, se kalimi i dosjes nga Prokuroria e Krimeve të Rënda do të thotë se nuk përfshin hetimin e dyshimeve për korrupsion ndaj gjyqtares, nuk qëndron. Sjellim në vëmendje se ky procedim penal është përcjellë i plotë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë e më pas në atë të Durrësit, referuar nenit 75/a të K. Pr. Penale dhe faktit se e kallëzuara ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Pra ndjekja penale për këtë vepër i përkiste juridiksionit të përgjithshëm penal dhe jo atij të posaçëm.

**42.** *Procedimi penal nr. \*\*\*/2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.*

42.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal nga burime të hapura, portal mediatik, në të cilat ngrihen dyshime se zyrtarë të Kadastrës dhe ALUIZNI-t në Durrës (shtetasit \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*), të arrestuar apo shpallur në kërkim policor së fundmi për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, ngjarje e gushtit 2019, kanë fituar shumë shpejt lirinë pas ndërhyrjeve të Drejtueses së Prokurorisë, znj. Jella (çështja e regjistrit penal, që do të gjejë trajtim në vijim).

42.2 Ndër të tjera, nga ky denoncim pretendohet se, në ndryshim nga dy raste të mëparshme, të sipërcituara, prokurori \*\*\*.\*\*\*, që kishte ndërmarrë veprime, por që në gjykatë ishte zëvendësuar me prokurorë të tjerë, në rastin e Drejtorit të Kadastrës Durrës, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, ka kërkuar vetë t'i drejtohet gjykatës për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, kërkesë e cila është vonuar qëllimisht për rreth 5 ditë nga drejtuesja, znj. Anita Jella. Vetëm pasi prokurori i çështjes, në një komunikim zyrtar me drejtuesen, i kujton se bllokimi i dërgimit të kërkesës në gjykatë përbën shkak për kallëzim penal pasi po shkelte ligjin, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar praktikën për dërgimin në gjykatë të kërkesës së prokurorit (ky fakt i pretenduar nga denoncimi, provohet nga udhëzimi i lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për rastin, administruar si provë në dosje të Komisionit).

42.3 Për sa më sipër, nisur dhe nga denoncime të tjera pranë ONM-së, më datë 6.11.2019, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016, i ka paraqitur Komisionit *një gjetje*.

42.4 Me anë të kësaj *gjetje*, e cila merret në cilësinë e provës që dëshmon një fakt që ka ndodhur mbi procedimin penal nr. \*\*\*/2019, konstatohet se ka ndodhur një vonesë, e cila i atribuohet znj. Anita Jella, në ndjekjen e procedurës si drejtuese për këtë procedim penal, pasi:

- (i) Nuk provohet që, më datë 26.9.2019, mbledhja e pretenduar nga subjekti ishte arsyeja për shtyrjen e depozitimit të kërkesës të përgatitur nga prokurori i çështjes \*\*\*.\*\*\*, për arrestimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, apo që kjo mbledhje të jetë mbajtur.

(ii) Përveç kësaj, fakti që me anë të vendimit nr. \*\*\*/1, datë 1.10.2019, të Gjykatës është caktuar masa “arrest me burg”, duke e gjetur të drejtë kërkesën e prokurorit, pra pa hetim shtesë të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, me anë të udhëzimit të saj me karakter “jo të detyrueshme”<sup>27</sup>, është provë që vërteton se kërkesa e subjektit ndaj prokurorit të çështjes ishte e panevojshme në këtë pikë. Ky konkluzion konfirmohet më tej dhe nga vendimi nr. \*\*\*/2, datë 4.10.2019, i Gjykatës.

(iii) E fundit, por jo nga rëndësia, është evidente që ishte e mundshme që të kërkohej regjistrimi i emrit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në regjistrin përkatës të prokurorisë që në datën 26 (të enjten) ose 27 (të premten), shtator 2019, pa prituri për të hënë, datë 30.9.2019.

42.5 Në vijim për sa më lart, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili, ndër të tjera, ka sqaruar se<sup>28</sup>: lidhur me vonesën mbi arrestimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, kërkesa drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit është dërguar nga prokurori \*\*\*.\*\*\*, në zyrën e saj, ditën e enjte në orën 15:30, datë 26.9.2019. Nisur nga rëndësia e faktit të shprehur në kërkesë, subjekti ka kërkuar t’i vihen në dispozicion të gjitha materialet hetimore lidhur me rastin, pasi nuk ishte vënë në dijeni të tyre nga prokurori i çështjes, si dhe për faktin se ky prokuror nuk bën pjesë në Seksionin e Krimit Ekonomik. Të nesërmen, në datën 27.9.2019, ditë e premte, subjekti ka shpjeguar sen për arsye objektive dhe të angazhimeve në këtë proces, nuk ka qenë në punë dhe ka autorizuar që materiali t’i kalohet për studim dhe për t’u firmosur drejtuesit të Seksionit të Krimit Ekonomik. Pas studimit të materialit nga ky i fundit, subjekti është bërë me dije se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe seksioni që ai drejtonte kishte në hetim edhe dy procedime të tjera lidhur me këto fakte dhe persona, për të cilët po kryeshin veprime proaktive, dhe se veprimet e kryera në një dosje hetimore mund të prishnin veprimet apo provat e procedimeve të tjera dhe, në këtë kuadër, duhej bashkëpunim midis të gjithë prokurorëve që ndiqnin çështjet për të rakorduar procedimet penale.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se, duke mos pasur asnjë problem lidhur me afatet për dorëzimin e kësaj kërkesë në gjykatë, në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, është vendosur që ditën e hënë, pasi atë ditë ishte e premte, të mbledheshim në një mbledhje me të gjithë drejtuesit e Prokurorisë dhe prokurorët që ndiqnin çështjet, për të organizuar punën dhe të bashkërendoheshin veprimet konkrete lidhur me shtetasin nën hetim. Prokurori i çështjes nuk është paraqitur për të diskutuar *dhe subjekti, si drejtuese, ka përpiluar një udhëzim me karakter jo detyrues*. Duke parë që prokurori i çështjes nuk e ka marrë parasysh këtë udhëzim, subjekti ka firmosur shkresën përcjellëse drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit.

42.6 Komisioni, pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, vendimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>29</sup> dhe atë të Apelit<sup>30</sup>, edhe në këtë rast<sup>31</sup>, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se mosveprimet e konstatuara të subjektit (në dy raste), nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin e tij me mangësi apo të papërshtatshme, duke vendosur transferimin e kësaj çështjeje pranë organit kompetent inspektues.

**43. Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, dhe se kjo vendimmarrje e Komisionit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të

<sup>27</sup> Komisioni referon se shkresa shoqëruese e kërkesës për urdhërimin e arrestimit është dërguar në datën 26.9.2019, datë përpara momentit kur është nxjerrë udhëzimi jo urdhërues.

<sup>28</sup> Referohuni komunikimeve me email të datës 4.10.2019.

<sup>29</sup> Vendimi me nr. \*\*\*/1, datë 1.10.2019.

<sup>30</sup> Vendimi me nr. \*\*\*-2019-\*\*\*, datë \*\*\*.10.2019.

<sup>31</sup> Referohuni në f. 36-37 të vendimit.

nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

43.1 Komisioneri Publik vendos në vëmendje që subjekti i rivlerësimit në trajtimin e këtij procedimi ka qenë në rolin e drejtuesit të Prokurorisë dhe veprimet e tij duhen vlerësuar brenda kriterit të aftësive profesionale, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe, për aq sa gjen zbatim, ligji nr. 96/2026, të ndryshuar.

43.2 Po ashtu, në vlerësimin e këtij rasti, merr rëndësi qëndrimi i ndryshëm i subjektit në çështje të ngjashme (si ai në procedimin penal nr. \*\*\*, i vitit 2019), pasi për procedimin penal nr. \*\*\*/2019, përtej shpjegimeve të dhëna mbi kompetencën e kufizuar ligjore në cilësinë e drejtueses, duke vepruar pikërisht në këtë cilësi, subjekti ka passjellë një seri ngjarjesh procedurale dhe vonesa të panevojshme, që duket sikur kanë synuar në mbrojtjen e personit nën hetim.

**44.** *Për sa i përket mungesës së koordinimit dhe ekzistencës së një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në muajin gusht të vitit 2019.*

44.1 Sikurse përmendën edhe më sipër, nga burime të hapura, Komisioni ka ardhur në dijeni të një procedimi penal lidhur me disa zyrtarë të ALUIZNI-t në Durrës (shtetasit \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*), të arrestuar apo shpallur në kërkim policor për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, ngjarje e gushtit 2019. Por të cilët, sipas denoncimit, kanë fituar shumë shpejt lirinë pas ndërhyrjeve të drejtueses së prokurorisë, znj. Jella, dhe zëvendësimit të prokurorëve.

44.2 Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës kopjen e fashikujve që i përkasin procedimeve penale në ngarkim të shtetasve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*, lidhur me legalizimet e kryera kur këta shtetas kanë qenë drejtues në Zyrën e ALUIZINI-t, Durrës. Pasi ka vlerësuar aktet e administruara dhe ka konstatuar se subjekti ka zëvendësuar prokurorin e çështjes \*\*\*, \*\*\*, me prokurorin \*\*\*, \*\*\*, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime, si dhe të paraqesë prova.

44.3 Në lidhje me procedimin penal në ngarkim të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se gjatë muajit gusht, konkretisht më datë 9.8.2019, prokuror i gatshëm ka qenë prokurori \*\*\*, \*\*\*, i cili ka kryer veprime hetimore dhe ka nxjerrë urdhra ndalimi për pesë shtetas, pa regjistruar procedim penal, si dhe pa shkresë përcjellëse të Prokurorisë, nga të cilët, në momentet e para, janë ekzekutuar vetëm dy prej tyre.

44.4 Në datë 11.8.2019, referuar grafikut të gatishmërisë, ka qenë i gatshëm prokurori \*\*\*, \*\*\*, i cili ka vijuar me regjistrimin e procedimit penal, përpilimin e kërkesave për vleftësimin e ndalimeve të kryera dhe caktimin e masave të sigurimit për katër të ndaluar. Më pas, në datën 28.8.2019, ka qenë i gatshëm prokurori \*\*\*, \*\*\*, dhe nga Policia Gjyqësore është ekzekutuar një urdhër ndalim i nxjerrë që në fillim të gushtit në kuadër të këtij procedimi penal, dhe për këtë shkak është kërkuar vleftësimi i ndalimit dhe caktimi i masës së sigurimit personal nga ky prokuror.

44.5 Më datë 12.9.2019, nga ana e prokurorit \*\*\*, \*\*\*, i cili bën pjesë në Seksionin e Krimit të Përgjithshëm, është paraqitur kërkesa për zëvendësimin e tij, pasi procedimi penal ishte regjistruar për veprat penale të cilat ndiqeshin nga Seksioni i Krimit Ekonomik. Në këto kushte, nisur nga fakti se nga ana e prokurorit \*\*\*, \*\*\*, i cili bën pjesë në Seksionin e Krimit

Ekonomik, ishte trajtuar një ndalim, pra një veprim urgjent, subjekti ka vendosur zëvendësimin e prokurorit \*\*\*.\*\*\* me prokurorin \*\*\*.\*\*\*.

44.6 Të tre prokurorët kanë kryer veprime urgjente gjatë muajit gusht, ku prokurori \*\*\*.\*\*\* ka nxjerrë urdhrat e ndalimit, prokurori \*\*\*.\*\*\* ka regjistruar procedimin penal, ka kërkuar vleftësimin e ndalimeve dhe caktimin e masave të sigurimit për disa prej të ndaluarave dhe prokurori \*\*\*.\*\*\* ka trajtuar kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit për një të ndaluar, të gjitha këto veprime të kryera në kuadër të këtij procedimi penal.

44.7 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 11, të ligjit nr. 84/2016, me opinionin e datës 14.11.2019, i ka kërkuar Komisionit që subjektit të rivlerësimit t’i kalohet barra e provës për të provuar ekzistencën e një regjistri efektiv dhe eficient mbi veprimet e ndjekura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, në gusht të vitit 2019.

44.8 Në këto kushte, për të provuar të kundërtën e barrës së provës së kaluar nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se secili prokuror ka të drejtë të kryejë tri javë leje të zakonshme, e drejtë e prokurorëve që përbënte një obligim për mua si drejtuese të parashikoj një periudhë të tillë në grafikun e gatishmërisë, duke dorëzuar dhe provat përkatëse mbi planifikimin e lejeve dhe gatishmërinë e prokurorëve gjatë muajit gusht 2019. Për më tepër, subjekti ka bashkëlidhur informacionet e prokurorëve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, në të cilat shpjegohet procedura e marrjes pjesë në çështjen në fjalë. Gjithashtu, subjekti ka argumentuar se, bazuar në ligjin për Prokurorinë, me ndryshimet e reja, Drejtuesi i Prokurorisë nuk ka asnjë rol në caktimin e masave të sigurimit, pasi vendos vetë prokurori i çështjes.

44.9 Në përfundim, sikurse dhe për çështjet e tjera në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ndër të tjera, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“...në asnjë rast nuk referohen shkelje konkrete të bëra nga subjekti i rivlerësimit në dosjet penale të hetuara prej saj. Denoncimet trajtonin çështje që kishin të bënin me pozicionin e saj si drejtuese, të cilat, në vlerësim me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 97/2016, tregonin sjellje korrekte të subjektit të rivlerësimit në shumicën e rasteve të hetuara...”*<sup>32</sup>.

**45. Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe të rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, nuk arriti të provonte të kundërtën për sa i është kaluar barrë prove. Nga kronologjia e ecursit të veprimeve procedurale të ndërmarra gjatë muajit gusht, në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës, bie në sy mungesa e organizimit të një sistemi efektiv dhe eficient, që, më së paku, ka vënë në rrezik cilësinë dhe rezultatet për procedimet penale aktive. Është fakt se në këtë situatë, rasti është trajtuar nga tre prokurorë të ndryshëm, të cilët kanë kryer veprime procedurale të ndryshme, e në disa raste të paregjistruara. Përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, dhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe sistemit të gatishmërisë<sup>33</sup>, pasi modalitete si ato mund të çojnë përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit.

<sup>32</sup> Për më tepër referohuni në f. 36-37, të vendimit të Komisionit.

<sup>33</sup> Në këtë drejtim, referohuni në nenin 80, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, sipas të cilit, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative të Kryetarit/Drejtuesit të Prokurorisë matet duke u bazuar në tregues që kanë lidhje me mirorganizimin e

**46.** Duke përfunduar për kriterin e aftësive profesionale, Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i cenueshëm, pasi ai bazohet në një vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe të ligjit të zbatueshëm. Në analizimin e këtij rasti vlen të theksohet raporti i ngushtë që ka procesi i rivlerësimit me rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, qëllim i përcaktuar në nenin 179/b, pika 1, të Kushtetutës. Në këtë këndvështrim, referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, në zbatim të nenit 61, pika 4, si dhe nenit 4, pika 2, dhe 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, konstatojmë se mangësitë e vërejtura janë të tilla, që nuk justifikojnë dhe të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë. Për pasojë, vendimi objekt ankimi duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

## **V. Kërkimi i ankimit**

**47.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

**48.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**49.** Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

**50.** Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**51.** Komisioneri Publik, pasi vlerësoi të drejtë dhe ndan të njëjtin qëndrim me rekomandimin e ONM-së, gjetjen dhe opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, kërkon që Kolegji i Posaçëm i Apelit të mundësojë trajtimin e këtij ankimi me prioritet në kohë, si dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zonjës Anita Jella.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**

I bashkëlidhet këtij ankimi:

Rekomandimi për ushtrim ankimi i ONM-së, nr. 105/3 prot., datë 12.2.2020, së bashku me aktet shoqëruese të tij.